REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 36117
Datë/Datum. 24.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 36/17.**
Nga:	Safije Saramati - Eksperte shqyrtuese		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizimi me medalje"**, me nr. të Prokurimit: **102-16-124-121**		
Përgjigjeje në ankesë:	**"Artisu Group" sh.p.k -Prishtinë**		
Datë			**24.02.2017**

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesen e parashtruar nga OE **"Artisu Group" sh.p.k** - Prishtine, kundër AK – **Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me medalje"** me nr. të Prokurimit: **102-16-124-121.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTES SHQYRTUESE

		13.02.2017		14.02.2017		24.02.2016
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **03.02.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **36/17,** e parashtruar nga OE **"Artius Group" sh.p.k** me seli në Prishtine, lidhur me aktivitetin të prokurimit **"Furnizimi me medalje"** me nr. të Prokurimit: **102-16-124-121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës"**

Konform nenit 113 dhe 114 Pjesa IX e LPP-së, si dhe vendimit nr. 712/15, të nxjerra nga paneli shqyrtues në lidhje me shqyrtimin e ankesave, Eksperti teknik-shqyrtues, e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjale si më poshtë

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Artius Group" sh.p.k me seli në Prishtine.

Pikat e Ankesës nga OE **"Artius Group" sh.p.k** nga **Prishtina,**

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Shkelja e Nenit 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi AK nuk ka respektuar këtë nen të LPP dhe ka bërë trajtim diskriminues.

Shkelja e Nenit 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve -Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Shkelja e Nenit 60: Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Shkelja e ELIGJIT Nr. 04/L-070: PËR DHËNIEN E DEKORATAVE NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, përkatësisht **Neni 16**

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Pas rivlerësimit me datën 24 Janar kemi pranuar Letrën Standarde dhe po te njëjtën dite pas kërkesës për sqarim te hollësishëm për arsyet e eliminimit kemi marrë procesin e vlerësimit për tenderët.

Janë disa arsye te qëndrueshme eliminimi për ne si OE . por ne kërkojmë qe tenderi te ANULOHET ne tërësi për shkeljet ne Vijim :

Sipas nenit 7 te LPP-së, Oferta e operatorit te rekomanduar për kontrate është e papërgjegjshme dhe

nuk është trajtuar sipas LPP

Shkelja e Tenit 59 : AK nuk ka ekzaminuar ofertat sipas nenit 59 pasi oferta e rekomanduar për kontrate nuk është ne përputhshmëri unë specifikat e kërkuara dhe e njëjta nuk është ne dimensionin e kërkuar, CE i rekomanduar për kontrate nuk ka përmbushur kriterin e Dimensioneve te Mostrës qe ishte kriter 3 deri ne 5 mm pasi OE i rekomanduar ka sjellë mostër me dimensione 5.2 mm, kurse ne Vendimin refuzues te datës 30.01.2017 me nr. 1 16/1 të lëshuar nga ana e AK, ne përgjigjen e dhëne për ketë pikë kontestuese AK. bie ne kundërshtim me specifikat ne dosjen e tenderit përkatësisht kriterin nr. 3 qe vetë e kanë vendosur.

Shkelja e nenit 60 : Ku autoriteti kontraktues nuk e ka përfillur kriterin për dhelje te kontratës ku ka rekomanduar një CE te papergjeshëm , i cili nuk ka përmbushur specifikat dhe ka bere shkelje gjate dorëzimit te mostrës te cilën nuk e ka pasur te lejuar ta dorëzojë.

Shkelja e ligjit nr.04/L-070: Për dhënien e dekoratave nga Presidenti I Republikës se Kosovës, përkatësisht **Neni 16**

Sanksionet : Punimi shitja, bartja e sendeve tjera që imitojnë Dekoratat e Republikës së i Kosovës është e ndaluar dhe Sanksionohet ne ligj.

Përgjigja e AK gjate shqyrtimit është tendencioze dhe e pabazë ku thuhet se OE i rekomanduar për kontrate ka pasur autorizime te mëhershme me baze te kontratës Se kaluar dhe medalja e ofruar i ka mbetur nga puna e mëhershme, por ne besojmë se OE i rekomanduar ka bere shkeljen e këtij ligji duke sjellë mostrën e njëjtë (Përkatësisht Medaljen Humanitare) gjë që sanksionohet me ligj sepse e njëjta mundet të punohet vetëm me urdhër të Presidencës, dhe është ndaluar te punohet, të shitet apo të mbahet nga

personat privat në këtë rast nga OE.

Kurse ne momentin e publikimit te tenderit OE i rekomanduar për kontrate nuk ka pasur asnjë marrëveshje, kontrate apo autorizim për punimin, shitjen apo mbajtjen e medaljeve te tilla qe janë te mbrojtura me ligjin 04/L-07) .

Edhe ne si OE kemi mundur dhe kemi kapacitete qe ta punonim medaljen e njëjte por prodhuesi me te cilin bashkëpunojnë nuk ka pranuar qe pa lejen speciale te Presidencës se Kosovës te punoje një mostër te njëjte pasi do te ishte shkelje ligjore dhe ne kemi dorëzuar dy mostra nga puna jone, e qe nuk janë te mbrojtura me ligj dhe ashtu siç është kërkuar ne DT por duke menduar se mostrat sipas dimezioneve do te punohen pas dhënies Se kallpëve nga ana e AK

S.S.

Nga kjo që u tha më lart kërkojmë që tenderi të Anulohet më tërësi dhe kjo procedurë dhe kjo procedurë të Ritemderohet.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 20.10.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: ..... Furnizim/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,.....14.11.2016
Afati i parapare per hapje te ofertave, pas zgjatjes, ... 14.11.2016

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	N.T.SH.P. "Coin"	Prishtinë	43.660.00€	JO
2.	"Artius Group" shpk	Prishtinë	32.922.00 €	JO

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - Teknik (N. 306)

Eksperti shqyrtues -, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1

Ekspertja shqyrtuese duke analizuar pretendimet në ankesë dhe sqarimet e bëra nga OE ankues, saqaron se OE Ankues vetë e pranon në ankesë, se janë disa arsye te qendrushme për eleminimin për ne is OE ankues, por ne kërkojmë që tenderi të anulohet në tërësi për shkeljet në vijim. Kjo lidhet me arsyet e eliminimit të këtij OE, ndërsa sqaroj se në përbërje të komisionit të vlerësimit të AK-së kanë qenë edhe dy anëtarë me përgatitje adekuate profesionale, një inxhinier i Kimisë dhe një inxhinier i Mekanikës, e që të dy me gradën Doktor Shkence në fushat përkatëse.

Ekspertja shqyrtues sqaron se OE ankues në këtë rast nuk kërkon që lënda të kthehet në rivlerësim, por kërkon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, prandaj duke pasur parasysh kërkesën e këtij OE dhe pranimin që është i papërgjegjshëm, ky OE konsiderohet palë pa interes juridik material konform nenit 4.1.26 të LPP-së. Edhe pse ky OE ankues është palë pa interes për hirë të transparencës më poshtë po i japim disa sqarime në lidhje me pretendimet ankimore.

S.S

Sqarimi 2

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar mostren siç është kërkuar prej 3-5 mm, por ka ofruar 5.2 mm, ekspertja shqyrtuese në lidhje me këtë çështje ka kontaktuar me përfaqësuesit e AK-së për ti sqaruar këto çështje, ndërsa nga ana e autoritetit kontraktues është sqaruar se mostra është kërkuar të sjellet vetëm si punë e mëparshme e llojit të njëjtë, pasi që veglat për madhësinë e medaljeve janë në pronësi të Zyrës së Presidencës së Kosovës dhe nuk mund të ketë ndryshime dhe mundësi tjera të punimit të mostrës, pasi që duhet të merren veglat e Zyrës së Presidencës së Kosovës për tu punuar medalja. Prandaj trashësitë e mostrës nuk janë relevante në këtë fazë por e rëndësishme është përbërja dhe metoda e punimit.

Sqarimi3

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë e ka shkelur Ligjin Nr.04/L-070 për dhënien e dekoratave nga presidenti i republikës së Kosovës përkatësisht nenin 16, ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë që bashkë me dosje jeni të obliguar ta sillni një punim (moster) origjinal nga puna juaj e llojit të njëjtë dhe të prezantohet mënyra e punimit (duhet të jetë me farkim), prandaj OE i rekomanduar për kontratë siç na ka sqaruar përfaqësuesi i AK-së ka pasur kontratë të mëhershme me AK-në dhe e ka ofruar mostrën duke ju referuar punimit të medaljes që ka pasur kontratë me AK-së, ndërsa nëse OE ankues mendon se kjo është e ndaluar me ligj atëherë ky OE le të ju drejtohet organeve tjera kompetente për këtë çështje, pasi që në dosje të tenderit kërkesa ka qenë në formën që e cekem më lartë.

Mendimi i ekspertit teknik:

Ekspertja e OSHP-së, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendojnë që Autoriteti Kontraktues – Zyra e Presidentit , për aktivitetin e prokurimit "**Furnizimi me medalje**",, me nr. të Prokurimit: **102-16-124-121** i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
Prandaj ekspertja - shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që vendimi i AK-së të Aprovohet, ndërsa ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar, pasi që OE ankues është palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit.

S.S